

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA

Nr./Br. 01/619/20

Nr.i fq./Br.str. \_\_\_\_\_

Data/Datum: 21.05.2020

PRISHTINË-PRISHTINA

**MARRËVESHJE PËR THEMELIMIN E FORUMIT PËR SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE**

**TË PËRBËRË NGA**

**ADMINISTRATA TATIMORE, AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE, AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL, AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS, AGJENCIA PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT, DHE DOGANAT E KOSOVËS**

**Prishtinë, Kosovë  
Maj 2020**

## SFONDI

Cilësia dhe saktësia e regjistrimit të tatimpaguesve konsiderohen si kërkesë themelore për efektivitetin e administratës tatimore, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në Kosovë<sup>1</sup>. Regjistrimi i tatimpaguesve është thellësisht i varur nga përfshirja e saktë dhe në kohë e të dhënave demografike mbi tatimpaguesit, dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e të dhënave të tilla. Si regjistrimi fillestar ashtu edhe mirëmbajtja kërkojnë vërtetimin e të dhënave kundrejt regjistrave themelorë për personat, bizneset, adresat dhe personat juridikë. Kështu, praktika e mirë ndërkombëtare e regjistrimit tatimor thekson gjithnjë e më shumë rëndësinë shkëmbimit të dhënave dhe mbështetjen në informacione nga regjistrat themelorë dhe burime të tjera të jashtme. Vendosija e mekanizmit për shkëmbim të dhënave dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve është hapi i parë me rëndësi kritike për përmirësimin e regjistrat tatimor.

Prandaj, palët kyçe të interesit për regjistrat themelorë në Kosovë, përfshirë ATK, ARBK, ARC, AKK, ASHI dhe Doganat, janë pajtuar të themelojnë një forum formal për ndarjen e të dhënave midis tyre.

### I. OBJEKTIVI

Qëllimi i forumit për ndarjen e të dhënave është t'u mundësojë të gjitha palëve të përfshira të shkëmbejnë në mënyrë sistematike dhe efikase të dhënat relevante të regjistrave dhe informacione të tjera, duke përmirësuar kështu saktësinë dhe fushëveprimin e informacionit në regjistra, dhe duke rritur aftësinë e tyre për të ushtruar funksionet e tyre përkatëse.

### II. PJESËMARRJA DHE MEKANIZMI QEVERISËS:

Forumi për shkëmbimin e të dhënave do të përbëhet nga dy përfaqësues (një i nivelit të lartë dhe një i nivelit teknik) nga agjencitë vijuese:

- Administrata Tatimore (ATK),
- Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI)
- Doganat e Kosovës
- ARBK (Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë)
- Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)
- Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)

Forumi për shkëmbimin e të dhënave do të bashkë-kryesohet nga përfaqësues të lartë të Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit dhe Administratës Tatimore të Kosovës. Sipas nevojës, Forumi do të themelohet me rregullore, dhe mund të nxirren rregullore ose udhëzime të mëtejshme për të formalizuar aspekte specifike të punës së Forumit.

### III. PËRGJEGJËSITË

**Forumi.** Për të ndihmuar në plotësimin e një hendeku të konsiderueshëm në situatën aktuale, ku shkëmbimi/ndarja e të dhënave nuk mbështetet në mënyrë adekuate nga pikëpamja institucionale, përgjegjësia kyçe e Forumit do të jetë sigurimi i koordinimit ndërmjet ATK-së, ARBK-së, ASHI-it (si lehtësues), AKK-së, ARC-së dhe Doganave. Forumi poashtu është përgjegjës edhe për të siguruar ndërlihdjen e këtij mekanizmi qeverisës me nisma më të gjera në nivel të Qeverisë për përmirësimin e shërbimeve elektronike, përfshirë përmirësimin e vazhdueshëm të platformës së përbashkët të ndërveprimit të udhëhequr nga ASHI.

---

<sup>1</sup> Banka Botërore "Përmirësimi i cilësisë së regjistrat të tatimpaguesve përmes ndarjes së të dhënave. Dokument i Politikave për regjistrimin tatimor në Kosovë", tetor 2019.

Në mënyrë të veçantë, Forumi do të jetë përgjegjës për:

- Identifikimin(hartëzimin) e të dhënave në regjistrat e përfshirë dhe rekomandimin e opsioneve për shkëmbimin e mëtejshëm të të dhënave;
- arritjen e marrëveshjes për ndarjen e të dhënave dhe protokollet e komunikimit, dhe për mobilizimin e mbështetjes qeveritare të nivelit të lartë për zbatimin e tyre të shpejtë;
- standardizimin e formateve dhe përkufizimeve të të dhënave dhe krijimin e një fjalori të të dhënave;
- mbikëqyrjen e zbatimit të nismave të dakorduara për shkëmbimin e të dhënave, përfshirë, nëse është e nevojshme, edhe pilotimin e tyre fillestar;
- diskutimin ad-hoc të shkëmbimit të dhënave dhe çështjeve të bashkëpunimit, kur ato lindin, dhe marrjen e vendimeve për zgjidhjen e tyre;
- analizimin, rekomandimin dhe formalizimin e opsioneve për zgjidhjet e platformës së përbashkët të ndërveprimit që do të zëvendësojnë zgjidhjet aktuale individuale nga pika në pikë;
- miratimin dhe dokumentimin e masave të duhura administrative, teknike dhe fizike për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe për parandalimin e përdorimit ose qasjes së paautorizuar në to;
- identifikimin e kostove që lidhen me ndarjen ose përputhjen e të dhënave ndërmjet palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, dhe arritjen e marrëveshjes/zotimit për institucionin/institucionet që do të mbulojnë kostot; dhe
- identifikimin, rekomandimin dhe mbështetjen e ndryshimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore mbi aktivitetet e lartpërmendura.

**Sekretariati.** ASHI dhe ATK-ja do të veprojnë si Sekretariat i Forumit. Agjenda e takimeve do të përcaktohet në konsultim të ngushtë me të gjithë anëtarët e Forumit.

Detyrat kryesore të rregullta të ndërmarra nga Sekretariati janë:

- Ndërmarrja e hulumtimeve siç aprovohet ose urdhëzohet nga Forumi;
- Mbështetja e Forumit në hartimin e strategjive dhe propozimeve për të avancuar qëllimet e shkëmbimit të të dhënave midis palëve të interesit në forum;
- Nëse është e nevojshme, mbështetja e Forumit në hartimin e termave të referencës për ekspertë si palë e tretë për zhvillimin e drafteve të strategjive dhe propozimeve, dhe mbikëqyrja e palëve të treta në emër të agjencive kryesore të Forumit;
- Koordinimi i shqyrtimit të strategjive dhe propozimeve për ndarjen e të dhënave dhe i bashkëpunimit të nevojshëm midis agjencive të Forumit për t'i sjellë ato për vendim përfundimtar/miratim nga Forumi;
- Ndërlidhja me anëtarët e Grupit Punues dhe palët e ndërlidhura për të avancuar detyrat e dakorduara;
- Hartimi i agjendës për takimet e Forumit rreth 4 javë përpara dhe shpërndarja e materialeve përkatëse rreth 1-2 javë para një takimi. Hartimi i procesverbalit të mbledhjeve të Forumit dhe Grupit Punues, i cili do të shpërndahet rreth 2-4 javë pas takimeve të tilla;
- Hartimi i korrespondencës, parashtrësive dhe raporteve të veprimtarisë;
- Adresimi i pyetjeve dhe komenteve nga anëtarët e Forumit dhe Grupit Punues dhe nga palë të jashtme të interesuara.

**Grupet punuese.** Forumi do të krijojë Grupe Punuese, për të ofruar këshilla të ekspertëve për tema të veçanta. Një grup punues zakonisht përbëhet nga zyrtarë/përfaqësues të departamenteve ose agjencive relevante për temën specifike. Pjesëmarrja e zyrtarëve relevantë nuk kufizohet vetëm në përfaqësuesit e agjencive që janë nënshkruar të këtij dokumenti. Anëtarët e grupit punues duhet të jenë të nivelit të duhur të lartë për të ofruar ekspertizën e tyre për çështje të grupit punues, si dhe duhet t'i ofrojnë Forumit këshilla për politikat strategjike.

Takimet e forumit mbahen të paktën një herë në dy muaj ose bazuar në vendimin e Forumit.

#### IV. NËNSHKRIMET

Duke dëshmuar sa më lart, Udhëheqësit e Agjencive e vërtetojnë këtë marrëveshje që hyn në fuqi me këtë nënshkrim.

Agjencia për Shoqërinë e Informacionit  
Kujtim Gashi, Drejtor

Administrata Tatimore  
Ilir Murtezaj, Drejtor

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve  
Nexhmije Selimi, Drejtore



Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Avni Ahmeti, Drejtor

Doganat e Kosovës  
Ibrahim Xhaka, Drejtor n.d.

Agjencia e Regjistrimit Civil  
Bekim Hoxha, Drejtor